



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 15.7.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Tefik Mehmeti, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi: Engin Beyoglu.

Në mbledhje morën pjesë edhe Bujar Demjaha, përfaqësues i kompanisë projektuese “A Desing”, Driton Lleshi, përfaqësues i kompanisë projektuese “Intech”, Lulëzim Kabashi, përfaqësues i kompanisë projektuese “APE”, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Asdren Osaj, shef i Zyrës për marrëdhënie me publikun, drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesi i OSBE – së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Filluan diskutimet rreth rendit të ditës.

Shemsi Veseli propozoi që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e radhës.

Me një abstenim, u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Lindje”;
3. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Qendër”;
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Perëndim”;
5. Raporti për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013;
6. Propozimvendimi për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike;
7. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve SOS Fshatit të fëmijëve në Prishtinë;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë, e tretë dhe e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Lindje”, të Propozimvendimit për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Qendër” dhe të Propozimvendimit për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Perëndim”, kryesuesi tha se është obligim, i cili rrjedhë nga Ligji për planifikim dhe ndërtim, pra Komuna duhet t’i miratojë këto tri plane.

- **Bujar Demjaha**, përfaqësues i kompanisë projektuese, bëri prezantimin e Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Lindje” duke elaboruar disa nga komponentët kryesore të tij.
- Prezantimin e Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Qendër”, e bëri **Driton Lleshi**, përfaqësues i kompanisë projektuese “Intech”, i cili po ashtu në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij projektplani.
- **Lulëzim Kabashi**, përfaqësues i kompanisë projektuese APE, prezantoi Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re – Perëndim”, duke i njoftuar të pranishmit rreth disa komponentëve kryesor të tij.

Për shqyrtimin e projektplaneve rregulluese, kryesuesi hapi diskutimin.

Aziz Pacolli kërkoi që të ndërrohet vija përkufizuese e projektplanit “Qendra” në zonën ku është e përkufizuar me rrugën “Holgen Petersen”. Propozoi që përkufizimi të caktohet me ndonjë objekt.

Mustafë Krasniqi tha se do ta bëjmë një analizë më të thukët që të ndikojmë edhe ne që këto projektplane të jenë më të plotësuara.

Shemsi Veseli fillimisht ngriti shqetësim rreth moskoordinimit të punëve me Komitetin për planifikim. Lidhur me këto projektplane tha se nuk ka mendim të ekspertëve, mungon analiza e kostos së realizimit të këtyre planeve etj. Gjithashtu në këtë material nuk jepet asnjë fjalë rreth ndërtimeve të egra, nuk ka infrastrukturë përcjellëse, është dashtë që të përshkruhen disa fjali se cilat kanë qenë rekomandimet, vërejtjet, takimet me qytetarë etj.

Përkundër këtyre vërejtjeve, shihet se në këto projektplane ka disa detaje dhe analiza që kanë munguar në planet e mëhershme.

Kryesuesi kërkoi nga përfaqësuesit e kompanive që drafti final i këtyre projektplaneve të jetë i lekturuar.

Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, tha se në këto kompani komuna ka angazhuar edhe koordinatorë dhe se me këto kompani janë harmonizuar edhe detyrimet e drejtorisë.

U konstatua se njëzëri u përkrahën Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Lindje”, Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Qendër” dhe Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes “Prishtina e Re - Perëndim” dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Lidhur me Raportin për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013, Tefik Mehmeti tha se krahasuar me raportin e vitit të kaluar, është një raport mjaft i detajuar. Një sugjerim për këtë raport është se nuk është cekur projekti për Parkun në lagjen “Arbëria”, i financuar me donacion.

Shemsi Veseli tha se projektet që kanë të bëjnë me infrastrukturën, kryesisht projektet rrugore, ku më se tetëmbëdhjetë rrugë në këtë raport vetëm janë të përshkuara, e që në fakt asnjëra nga ato nuk ka filluar te realizohet. Kërkoi që ato projekte të hiqen nga raporti. Po ashtu thuhet se janë disa rrugë në tenderim etj.

Përkundër këtij sugjerimi, vërehet se ky raport ka avancim krahasuar me gjashtë mujorin e vitit të kaluar.

Milazim Vitija tha se edhe përkundër kërkesës që ka bërë BL e fshatit Marec, asnjë rrugë nuk ka hyrë në projekt për t’u realizuar. Kërkoi që të paktën të bëhet asfaltimi i rrugës Viti - Bullaj.

Avdullah Hoti tha se në këtë gjashtëmujor i kemi trajtuar të gjitha këto rrugë, dhe e kemi shqyrtuar listën e rrugëve rurale dhe urbane.

U konstatua se njëzëri u përkrah Raporti për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e mjeteve SOS Fshatit të fëmijëve në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja mbaroi në orën 16:20.

Procesmbajtësi

Zijadin Gashi

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc.i dipl.